Abrahams: Refuzimi i rrezikshëm i së vërtetës për luftën

Nuk mund të ketë pajtim dhe normalizim nëse çështja e krimeve të luftës nuk adresohet plotësisht, thotë Fred Abrahams nga Human Rights Watch

Agron Bajrami

Refuzimi që po i bën Qeveria e Serbisë së vërtetës për luftërat e viteve '90 dhe krimeve që janë kryer në to është shumë i rrezikshëm. Kështu thotë Fred Abrahams, aktivist për të drejtat e njeriut, i cili ka vite që punon si hulumtues për organizatën e mirënjohur Human Rights Watch.

Abrahams, i cili ka raportuar për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë, në vitet 1998-1999, dhe ka dëshmuar në gjykimet e krerëve serbë përgjegjës për krimet kundër shqiptarëve, në Tribunalin e Hagës, thotë se caktimi i një krimineli të dënuar të luftës për të ligjëruar në Akademi ushtarake shtetërore, siç ka bërë Qeveria e Serbisë me gjeneralin Vladimir Lazareviq, është njëjtë sikur të caktosh një përdhunues të dënuar që të japë mësim për edukatë seksuale.

Në intervistën dhënë "Kohës Ditore", Abrahams flet edhe për përvojën e tij personale si dëshmitar në gjykimin e Milosheviqit dhe krerëve të tjerë serbë në Tribunalin e Hagës, si dhe për përvojat më emocionale e trishtuese nga puna e tij si hulumtues i krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut gjatë viteve 1998-1999 në Kosovë.

Fred Abrahams është dhe autor i librit "Shqipëria moderne", botuar në anglisht dhe përkthyer në shqip nga shtëpia botuese "Dudaj".

"Koha Ditore": Duket se ka një trend në rritje në Serbi në rehabilitimin e atyre që kanë kryer krime të luftës në vitet '90. Së voni, gjenerali serb Vladimir Lazareviqi, i cili u shpall fajtor për krime të luftës, të kryera ndaj civilëve shqiptarë të Kosovës në vitin 1999, dhe u dënua me 14 vjet burgim, u lavdërua si hero kombëtar nga shteti i Serbisë dhe zyrtarët qeveritarë pasi u lirua nga burgu ku kaloi dy të tretat e dënimit. Për më tepër, qeveritarët serbë madje e emëruan atë si ligjërues në Akademinë ushtarake. Çka tregon kjo për vetë Serbinë dhe çështjen e përgjithshme të pranimit të përgjegjësisë dhe pasojave për të këqijat e shkaktuara?

Fred Abrahams: Emërimi i një të dënuari për krime lufte si ligjërues në një Akademi ushtarake është sikur të kërkosh prej një dhunuesi të japë mësim për edukatën seksuale. Apo një hajni ta ruajë bankën. Ai mund të ketë ekspertizë në çështjet ushtarake, por qartë se nuk ka respekt për kufijtë e moralitetit dhe të ligjit.

Nuk jam i sigurt për "vetë Serbinë", por emërimi tregon shumë për Qeverinë e Serbisë dhe përfshirjen e saj në superpatriotizëm për përfitime politike.

"Koha Ditore": Si njeri që ia ka përkushtuar jetën e tij çështjeve të të drejtave të njeriut, ju duket ofenduese kjo, kur Qeveria e një shteti që pretendon të jetë demokratike thjesht e injoron të vërtetën e së kaluarës, i mohon të këqijat që ua ka shkaktuar viktimave, sikur edhe krimet që janë kryer nga institucionet e shtetit?

Abrahams: Nuk e gjej aq ofenduese sa më duket e rrezikshme. Kur cilado Qeveri refuzon të vërtetën – qoftë ajo për krime lufte, imigrim apo ndryshime klimatike – ajo inkurajon politikat manipuluese që kërcënojnë të mirën e përgjithshme. Ajo lejon që mjeshtërit e emocioneve dhe komunikimit të dominojnë debatin mbi ata që kanë analiza dhe politika të arsyeshme. Në një rajon si Ballkani, me kujtimet ende të freskëta dhe emocionet ende të gjalla, me mekanizmat e fuqisë së shtetit ende të dobëta, kjo paraqet një rrezik të posaçëm.

"Koha Ditore": Përgjithësisht në gjithë rajonin, por posaçërisht duket në Serbi, çështja e përgjegjësisë për krime të luftës ose vihet nën tepih ose mohohet tërësisht. Mendoni se rajoni është i gatshëm për të qenë pjesë e Bashkimit Evropian pa qenë i aftë të ballafaqohet me të kaluarën e afërt, dhe të pranojë përgjegjësinë për të? Duhet të jetë BE-ja më insistuese në çështjen e ballafaqimit me të kaluarën dhe pranimit të përgjegjësisë?

Abrahams: Bashkimi Evropian dhe shtetet perëndimore përgjithësisht kanë marrë një qasje shkurtpamëse ndaj drejtësisë dhe krimeve të së kaluarës. Në momente të caktuara ato nuk kanë mundur t'i shmangen insistimit në këtë, sikur që ishte rasti i arrestimit të Mladiqit apo Karaxhiqit, por ato nuk e kanë shtyrë këtë gjë me konsistencë në gjithë rajonin si një kërkesë qendrore. Nuk jam naiv rreth shumë konsideratave, por stabiliteti dhe progresi politik do të jenë të kufizuara derisa kriminelët e luftës të jenë të lirë.

Njëkohësisht, mohimi dhe distancimi nuk do të ndihmojnë. Procesi i përfshirjes mund të krijojë hapësirë për reflektime, përgjegjësi dhe llogaridhënie. Mund të inkurajojë dialogun dhe të forcojë institucionet për të sfiduar narrativat e ngulitura.

Brenga më e gjerë, mendoj unë, nuk është vetëm progresi i shteteve ballkanike, por edhe regresi demokratik i disa shteteve të BE-së, rrjedhimisht dhe i gjithë unionit si tërësi.

Një copëz drejtësi...

"Koha Ditore": Ju keni qenë pjesë e ekipit të Human Rights Watch-it, që ka hulumtuar, dokumentuar dhe raportuar disa nga krimet e kryera në Kosovë në vitet 1998-1999. Ndjeni se drejtësia është vënë në vend për ato që kanë ndodhur këtu, gjatë luftës?

Abrahams: Një copëz e drejtësisë. E gjej domethënëse që Milosheviqi, Lazareviqi dhe të tjerët e gjetën veten para gjyqit. Natyrisht, kjo është larg prej të qenit mjaftueshëm, dhe ky është paradoksi i drejtësisë ndërkombëtare. Mund të dënohesh me burgim të përjetshëm për vrasjen e një personi, por vetëm një dyzinë vitesh për vrasjen e qindra të tjerëve më shumë.

Më pas, janë edhe shumë njerëz nën nivelin e udhëheqësve më të lartë në gjithë ish-Jugosllavinë të cilët nuk kanë frikë nga arrestimi; të ashtuquajturit "peshq të mesëm" që lajtën një rol qendror në krimet masive. Disa prej këtyre njerëzve janë ende aktivë në politikë dhe jetën publike.

Në anën tjetër, janë peshqit e vegjël, njerëz sikur këta që janë duke u gjykuar në Beograd për krimet e rënda të kryera në Qyshk. Këta njerëz meritojnë të dënohen, por ata ishin këmbësori në një fushatë monstruoze. Ata mund të sakrifikohen për t'i treguar Evropës dhe të tjerëve se ka progres (edhe pse edhe në këtë rast është progres i bllokuar). Por, çka t'i bëjmë komandantëve që i hartuan planet dhe i dërguan banditët e armatosur në fshatrat rreth Pejës?

"Koha Ditore": Ju, po ashtu, ishit edhe dëshmitar në Tribunalin e Hagës, ku dëshmuat në gjykimin e Slobodan Milosheviqit sikur edhe në gjykimet e Milan Milutinoviqit, Nikola Shainoviqit, Dragolub Ojdaniqit, Nebojsha Pavkoviqit, Vladimir Lazareviqit dhe Sreten Lukiqit. Si jeni ndjerë kur u përballët me njerëzit që planifikuan dhe urdhëruan gjithë ato krime të tmerrshme dhe, siç dukej qartë, kurrë nuk ndien asnjë keqardhje për veprimet e tyre?

"Bashkimi Evropian dhe shtetet perëndimore përgjithësisht kanë marrë një qasje shkurtpamëse ndaj drejtësisë dhe krimeve të së kaluarës", thotë Abrahams

Fred Abrahams ka dëshmuar në gjykimet e Hagës kundër Milosheviqit dhe krerëve të tjerë serbë, që kanë kryer krime ndaj shqiptarëve, ndërsa është edhe autor i librit "Shqipëria moderne", botuar në anglisht dhe përkthyer në shqip nga shtëpia botuese "Dudaj"

Abrahams: Në nivelin personal, ishte shumë përmbushëse. Pas aq shumë vitesh të dokumentimit të kërdisë dhe mjerimit që ata shkaktuan, unë mund t'i sfidoja këta njerëz ballë për ballë. Po ashtu, ndieja se mund të flas në emër të qindra njerëzve që m'i treguan rrëfimet e tyre të dëmtimit dhe dëshpërimit. Është një barrë të shënosh këto rrëfime si një hulumtues për të drejtat e njeriut, ato të rrinë si barrë e rëndë e përgjegjësisë deri sa nuk e publikon raportin tënd dhe i tregon botës dhe, në rastin tim, jep dëshmi para një gjykate.

Njëkohësisht, e dija që Tribunali i Hagës ofron një mekanizëm të papërkryer për adresimin e këtyre krimeve. Ishte menduar gjithmonë që të shkoj pas një numri të vogël krerësh të lartë, duke i lënë komandantët e nivelit të mesëm që i përmenda më herët të lirë. Dhe kurrë nuk ishte menduar si një ushtrim i tregimit të së vërtetës që do të vendosë një histori për atë që ndodhi.

"Koha Ditore": Nga përvoja juaj personale si hulumtues i HRW-së dhe raportues nga Kosova, cili ishte rasti më i rëndë për të cilin mbloditë dëshmi, emocionalisht dhe profesionalisht?

Abrahams: Më sfiduese emocionalisht me gjasë ishte koha që kalova me familjen Deliaj në Abrinë e Epërme. Kjo për arsyen se ne arritëm në vendngjarje shkurt pas masakrës, në shtator të vitit 1998, dhe shikuam si familja i mori të afërmit nga mali për t'i varrosur. Unë kalova kohë me atë familje më vonë dhe dëshmova rreth saj në Tribunalin për krime lufte.

Në rrafshin profesional, hulumtimi që bëmë rreth dhunimeve dhe dhunës seksuale u dëshmua të jetë shumë i vështirë për shkak se shumë gra, që ishte e kuptueshme, hezitonin të flisnin – nga frika, trauma apo turpi. Kam shikuar me brengë si Qeveria e Kosovës dhe të tjerët flisnin për rreh 20.000 viktima. Kurrë nuk e kam reduktuar seriozitetin dhe përmasën e këtyre krimeve, por nuk jam i bindur se dëshmia e mbledhur deri tani mund t'i përkrahë ato pretendime.

Por puna më sfiduese ishte kuptimi i veprimeve të UÇK-së. Një arsye ishte struktura dhe organizimi nebuloz. Por, tjetra ishte hezitimi i shqiptarëve kosovarë që të flasin për ato që kanë parë dhe që i dinin, ose për shkak të patriotizmit ose nga frika. Sikur në të gjitha konfliktet ku kemi punuar, puna ishte që të dokumentonim shkeljet e ligjeve të luftës nga të gjitha palët, qofshin ato forcat serbe, UÇK-ja apo NATO-ja.

"Koha Ditore": Pse mendoni se kriminelët e dënuar, që shkaktuan shumë vuajtje edhe për popullin e tyre, ende shikohen dhe lartësohen si heronj dhe patriotë nga Qeveria serbe dhe një pjesë e madhe e shoqërisë serbe?

Abrahams: Përgjigjja për këtë gjendet në një analizë të psikologjisë, sociologjisë, kriminologjisë dhe politikës, dhe unë nuk jam ekspert i asnjërës prej këtyre. Natyrisht, është jashtëzakonisht e zorshme që të nxirret jashtë binarëve një tren nacionalist, andaj dhe ndryshimi i drejtimit pas një drame çfarë është lufta merr kohë. Po ashtu, mendoj se mohimi dhe glorifikimi i shërben elitave politike. Narrativi për një gjendje shtetrrethimi, heronj në luftë, është i përdorshëm për të zhvendosur vëmendjen larg çështjeve shumë më banale, por që janë me rëndësi kritike sepse ndikojnë tek njerëzit në jetën e përditshme: shkollat, spitalet, rrugët. Kjo e kthen vëmendjen larg keqqeverisjes, korrupsionit dhe llogarive bankare jashtë shtetit. I forcon banditët. Dhe lejon që kritikët të heshtin si tradhtarë.

"Koha Ditore": E shihni një refuzim të ngjashëm për të pranuar të vërtetën për krimet e luftës edhe në shtetet e tjera të rajonit, dhe si mund të adresohet kjo çështje?

Abrahams: Serbia nuk ka monopol në këtë trend. Dhe kjo shtrihet përtej Ballkanit, po ashtu. Mendoj këtu në përpjekjet në shtetin tim, në Shtetet e Bashkuara, për t'i mbajtur njerëzit përgjegjës për vdekjet e civilëve në Afganistan dhe Irak, apo për torturat në rrjetet e burgjeve sekrete.

Nuk ka një linjë të drejtë për të arritur cakun. Por, një kërkesë fondamentale në Ballkan, mendoj, është zhvillimi ekonomik ashtu që njerëzit të mundë t'i shohin dobitë nga bashkëpunimi rajonal. Prej aty, njerëzit mund të kenë një bisedë më të sinqertë rreth asaj që ka ndodhur dhe si të parandalohet një gjë e tillë në të ardhmen. Kjo, po ashtu, e redukton edhe rrezikun nga politikanët nacionalistë agresivë në të gjitha anët – një trend global në rritje ky – që luajnë lojën e mllefit, frikës dhe të pakënaqësisë.

Gjykata Speciale nuk do ta njollosë UÇK-në

"Koha Ditore": Në rastin e Kosovës, ka një Gjykatë Speciale tani për krimet që supozohet se janë kryer nga pjesëtarë të ish-UÇK-së. Pritet që aktakuzat e para të ngrihen së shpejti. Por meqë gjykata është e kufizuar në raste dhe akuza specifike, ka kritika se kjo është e padrejtë ndaj Kosovës, meqë ajo përjashton krimet e kryera nga policia dhe ushtria shtetërore serbe. Mendoni se do të ishte më e drejtë nëse mandati i Gjykatës Speciale do t'i përfshinte të gjitha krimet e luftës që janë kryer në Kosovë në vitet 1998-1999?

Abrahams: Nëse bëhet si duhet, Gjykata Speciale mund të ndihmojë që të arrihet drejtësia për krime serioze – edhe kundër serbëve edhe kundër shqiptarëve në Kosovë. Numri i madh i njerëzve që mbetën të pagjetur pas luftës flet për veten. Por kjo është larg nga të qenit një institucion i përkryer. Natyrisht, një gjykatë që adreson krimet nga të gjitha palët do të ishte e preferuar, por kjo ishte një opsion jorealist dhe jofunksional. Si e tillë, kjo ofron një mundësi për t'i vendosur disa fakte dhe për të adresuar retë e akuzave me një proces që është kredibil dhe i drejtë. Nuk pajtohem me ata që thonë se gjykata do të njollosë UÇK-në apo të tjerët, që kanë sakrifikuar për t'i dhënë fund represionit. Gjykata do t'i gjykojë individët për akte specifike, disa prej tyre të kryera pasi që luftimet janë ndërprerë.

"Koha Ditore": Për fund, me dialogun Kosovë-Serbi të ndërmjetësuar nga BE-ja që ndodh tash e sa kohë, a mendoni se mund të ketë një normalizim të vërtetë mes dy vendeve dhe popujve, nëse çështja e krimeve të luftës nuk adresohet plotësisht dhe nëse përgjegjësia nuk pranohet?

Abrahams: Nuk e besoj se mund të ketë pajtim dhe normalizim, nëse çështja e krimeve të luftës nuk adresohet plotësisht. Por unë shoh rrugë të ndryshme përmes së cilave ky proces mund të zhvillohet. Llogaridhënia e plotë dhe ndëshkimi për krime janë jorealiste dhe nuk ndihmojnë, andaj dhe një balancë është i nevojshëm mes drejtësisë dhe ekspozimit të së vërtetës. Modele të ndryshme ekzistojnë, por më e rëndësishmja është, sipas mendjes sime, që shtetet dhe popujt të ish-Jugosllavisë të gjejnë një model që funksionon për ta – që nuk mund të imponohet nga jashtë. Dhe i theksoj këtu njerëzit po aq, nëse jo më shumë, sa shtetet. Asnjë nga ish-republikat nuk kanë Qeveri demokratike si duhet, andaj dhe qytetarët kanë një rol dhe përgjegjësi që të propozojnë zgjidhje për të mirën e përbashkët. Një pikënisjeje mund të jetë ringjallja e procesit për të zbuluar fatin e personave të pagjetur.

© KOHA Ditore